

KOMUNA E FORLÌ

KARTA E SHËRBIMEVE EDUKATIVE DHE SHKOLLORE KOMUNALE PËR MOSHEN 0-6 VJEÇARE

Prezantimi

INDEKS:

1. ÇFARË ËSHTË KARTA E SHËRBIMIT
2. LEGJISLACIONI REFERUES
3. TË DREJTAT, VLERAT DHE GARANCITË THEMELORE
4. IDENTITETI ARSIMOR I SHËRBIMEVE EDUKATIVE DHE SHKOLLORE PËR MOSHËN 0-6 VJEÇ
5. ROLET DHE PROFESIONALITETET
6. ORGANIZIMI I ÇERDHES
7. ORGANIZIMI I KOPSHTIT
8. ATELIER "COME TI DI LUNA"
9. BIBLIOTEKA PEDAGOGJIKE "DUILIO SANTARINI"
10. HIGJIENA, SHËNDETI DHE SIGURIA
11. MUNDËSITË DHE ORGANET E PJEËMARRJES
12. QASJA NDAJ SHËRBIMEVE DHE KONTRIBUTET
13. INFORMACIONET, REFERENCAT DHE KONTAKTET

SHËNIM LEXIMI

Shprehjet "fëmijë" dhe "fëmijët" janë përdorur pa dallim, në mënyrë që të mos rëndohet teksti, për të treguar si meshkujt ashtu edhe femrat. Prandaj, sa herë që do ti lexoni, do ti kuptoni si "djalë / vajzë", "djemtë/vajzat". Vetëm në disa raste janë përdorur të dyja gjinitë.

Fjalë të tilla si "kordinatorë pedagogjikë", "edukatorë", "bashkëpunëtorë" dhe "operatorë" janë përdorur për të dy gjinitë, në të tjera raste në gjininë mashkullore. Në rastet e fundit, përdorimi i mashkullores është bërë për arsye funksionale, në mënyrë që të mos rëndohet teksti.

Kemi përdorur qëllimisht gjininë femërore kur i jemi referuar situatave specifike.

1. COS'È LA CARTA DEI SERVIZI

1. ÇFARË ËSHTË KARTA E SHËRBIMIT

Karta e shërbimit është një dokument që synon të përcaktojë se si duhet të jenë marrëdhëniet midis Administratës komunale dhe familjeve, fëmijët e të cilave frekuentojnë çerdhet dhe shkollat e arsimit parashkollor të administruara nga Komuna e Forlì.

Karta e shërbimeve komunale për fëmijët 0-6 vjeç është krijuar si një mjet themelor për dialog dhe diskutim, është një pakt midis komunës që ofron shërbimin dhe përdoruesve të tij për të garantuar barazi në të drejtën e qasjes, trajtim të barabartë, informacion të plotë, pjesëmarrje, vlerësim të cilësisë së shërbimeve që ka për qëllim transparencën dhe përmirësimin e këtij shërbimi.

Ky dokument është rezultat i rishikimit të Kartës së mëparshme të çerdheve dhe të qendrave komunale të arsimit parashkollor, të miratuar në 2004.

Përpunimi aktual i Kartës është rezultat i një procesi pjesëmarrës që përfshiu familjet, personelin e shërbimit, kordinimin pedagogjik e zyrat e Shërbimit kompetent komunal.

2. NORMATIVA DI RIFERIMENTO

2. LEGJISLACIONI REFERUES

Karta e shërbimeve komunale për fëmijët 0-6 vjeç të komunës së Forlì-s ka si synim një perspektivë që konsideron, para së gjithash, fëmijën si subjekt ligjor.

Prandaj, ka si burim frymëzimi nenet 2 dhe 3 të Kushtetutës italiane dhe, për aq sa kanë lidhje me to, edhe nenet 33 dhe 34.

Gjithashtu bazohet në treguesit cilësor të vendosur nga Rrjeti i Fëmijëve të Komunitetit Evropian në vitin 1996 dhe në parimet e përfshira në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (Ligji nr. 176/91). I referohet gjithashtu dokumentit "Një kuadër evropian për cilësinë e arsimit dhe shërbimeve të kujdesit për fëmijët: propozimi i parimeve kryesore. Raport i përgatitur nga Grupi i Punës Tematik për Edukimin dhe Kujdesin e Fëmijërisë nën drejtimin e Komisionit Evropian". (2014. trad. It. 2016).

Referenca të tjera ligjore në nivel kombëtar dhe rajonal përsa i përket çerdheve dhe kopshteve, pjesë të arsimit parashkollor janë:

- "Udhëzimet kombëtare për kurrikulat e kopshteve dhe ciklin e parë të arsimit" Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimeve shkencore, 2012;
- Ligji nr. 107/2015 "Reforma e sistemit kombëtar të arsimit, e aftësisë dhe delegimit për riorganizimin e dispozitave legjislative në fuqi";
- Ligji nr. 62/2000, "Rregullat për barazinë shkollore dhe dispozitat mbi të drejtën e studimit dhe arsimit";
- Dekreti Legjislativ n. 65/2017 "Krijimi i sistemit të integruar të edukimit dhe arsimit që nga lindja deri në moshën gjashtë vjeçare";
- "Udhëzimet kombëtare dhe skenarët e rinj", 2018;
- Ligji Rajonal n.19 / 2016 "Shërbimet edukative për fëmijërinë e parë. Shfuqizimi i L.R. Nr. 1 të 10 janarit 2000".

- "Direktiva mbi kërkesat strukturore dhe organizative për shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe rregullat procedurale të lidhura me të. Disiplina e shërbimeve rekreative dhe iniciativat e pajtimit në zbatim të L.R. 19/2016, Rajoni Emilia-Romagna "(miratuar me D.G. 1564 të 16/10/2017;

- D.G.R. 704/2019 "Akreditimi i çerdheve në zbatim të Ligjit Rajonal Nr. 19/2016;

Të kordinuara ngushtë me përmbajtjen e Kartës së Shërbimit, janë udhëzimet dhe dispozitat e përfshira në Rregulloren Komunale të Shërbimeve për Fëmijët, miratuar me Rezolutën e Këshillit Bashkiak nr. 31 të 15/5/2018.

3. DIRITTI, VALORIE GARANZIE FONDAMENTALI

3. TË DREJTAT, VLERAT DHE GARANCITË THEMELORE

Komuna njeh në radhë të parë djemtë dhe vajzat si subjekte të të drejtave individuale, ligjore, civile dhe shoqërore.

Për një shërbim edukativ, të konsiderosh fëmijët si subjekt i ligjit do të thotë të konsiderosh zhvillimin dhe rritjen e tyre si një vlerë për të gjithë komunitetin dhe për këtë arsye të pranosh me vetëdije përgjegjësinë e arritjes së shtetësisë së tyre të plotë.

Sipas kësaj perspektive, një shërbim edukativ nuk mund të mos ta mendojë veten si pjesë e komunitetit më të gjerë në të cilin bën pjesë dhe, prandaj, të zhvillohet sipas logjikës së ndarjes së përgjegjësiave edukative, duke punuar për të forcuar rrjetin e bashkëpunimit me subjekte të tjera institucionale të cilat, për arsye të ndryshme dhe në mënyrë plotësuese, merren me fëmijërinë.

TË DREJTAT THEMELORE

• E DREJTA E FËMIJËVE PËR EDUKIM

Komuna punon për të siguruar që djemtë dhe vajzat të respektohen si persona. Njeh, në veçanti, të drejtën e djemve dhe vajzave për edukim.

Prandaj organizimi i shërbimit dhe i aktiviteteve janë planifikuar duke marrë parasysh, para së gjithash, nevojat specifike të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve në çerdhe / shkollë. Për këtë qëllim, mësuesit sigurojnë mësimdhënien efektive, duke marrë parasysh moshën e fëmijëve dhe duke vlerësuar aktivitetet didaktike. Vëmendja ndaj proceseve edukative, ka për qëllim zhvillimin e aftësive individuale të fëmijëve. Përforcohen edhe mënyrat e vazhdimësisë midis çerdes / kopshtit / shkollës fillore dhe format e përfshirjes së familjeve në planin edukativ të shërbimit.

• E DREJTA E FËMIJËVE NË NJOHJEN E IDENTITETIN PERSONAL, BARAZISË NDAJ MUNDËSIVE DHE NDAJ VLERËSIMIT TË NDRYSHIMET

E drejta e çdo fëmije për të njohur identitetin e tij është e garantuar. Për këtë qëllim, zhvillohen dhe organizohen aktivitete që vlerësojnë dallimet gjinore, të moshës, të etnisë, të fesë, të kulturës.

Administrata komunale garanton mundësi të barabarta edukative dhe zhvillimi për të gjithë fëmijët. Në organizimin e shërbimit dhe planifikimit të aktiviteteve, vëmendje i kushtohet nevojave dhe ritmit të zhvillimit të secilit fëmijë; promovohet integrimi i fëmijëve me deficite ose që ndodhen në situata të vështira / o disavantazhe socio-kulturore.

• E DREJTA E FËMIJËVE QË TË KENË NJË MJEDIS TË KËNDSHËM DHE STIMULUES DHE NJË KLIMË TË PËRGJITHSHME MIRËQËNIE

Konteksti edukativ është i organizuar për të inkurajuar zhvillimin e potencialit të fëmijës dhe tregohet kujdes në mënyrë që të jetë i këndshëm dhe stimulues.

Aktivitetet edukative dhe didaktike organizohen me qëllimin e zhvillimit gradual të autonomisë së cilitdo fëmijë.

Operatorët i kushtojnë vëmendje të veçantë metodave edukative, në mënyrë që të ndërtojnë një klimë të përgjithshme mirëqënie në seksionin e çerdes / shkollës.

Mirëpritja e fëmijëve në shërbim, në veçanti, bëhet përmes metodave të "ambientimit" që synojnë një qasje pozitive ndaj mjedisit të ri dhe një shkëputje graduale nga figurat e prindërve.

• **E DREJTA E CILËSISË SË SHËRBIMIT**

Administrata komunale merr përsipër të respektojë kriteret dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni aktual dhe të garantojë një shërbim cilësor, gjithashtu duke përcaktuar kriteret, standartet dhe objektivat e veta që do të ndjekë. Format periodike të vlerësimit të shërbimit promovohen, duke përfshirë edhe prindërit.

Stafi mësimor kujdeset për planifikimin edukativ, duke propozuar aktivitete të larmishme në bazë të mënyrës së mësimdhënies, të kohës, të hapësirave dhe aktiviteteve, në lidhje me interesat, nismat dhe aftësitë e fëmijëve. Planifikimi pedagogjik ka si qëllim vlerësimin e ndryshimit të kulturave dhe të proceseve evolutive. Për këtë qëllim, sigurohen momente të formimit dhe të trajnimit të përhershëm të stafit.

Administrata është e angazhuar për të siguruar cilësinë e të ushqyerit, si në çerdhe ashtu edhe në shkolla.

• **E DREJTA PËR VAZHDIMIN E DHËNIES SË SHËRBIMIT**

Administrata angazhohet për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit, duke u siguruar, në situata të zakonshme, familjeve të fëmijëve të regjistruar:

- vazhdimësinë e vendit ku zhvillohet mësimi dhe të orarit ditor të funksionimit;
- mbajtjen e raporteve numerike fëmijë-të rritur dhe të figurave referuese;
- kryerjen e aktiviteteve edukative të planifikuara.

• **E DREJTA E FAMILJES PËR TRANSPARENÇË**

Familjet kanë të drejtën e marrjes, brenda kufijve të legjislacionit për privacy, të të gjitha informacioneve në lidhje me organizimin dhe ofrimin e shërbimit; ata gjithashtu kanë të drejtë të shprehin vëzhgimet, sugjerimet dhe vlerësimet e tyre mbi shërbimin e marrë.

Administrata, përveç asaj që përmbahet në Kartën e Shërbimit, merr përsipër t'u sigurojë familjeve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me shërbimet për fëmijët, dispozitat që i rregullojnë ato, parimet edukative që i frymëzojnë; në veçanti, merr përsipër të qartësojë dhe bëjë të njohur kriteret për pranimin dhe menaxhimin e listave të pritjes.

• **E DREJTA E FAMILJES NË PJESËMARRJEN DHE INFORMIMIN MBI AKTIVITETET EDUKATIVE**

Operatorët dhe kordinatorët pedagogjikë marrin përsipër, secili sipas aftësive të tyre dhe sipas procedurave të parashikuara në Rregulloret dhe në Projektin Pedagogjik të Shërbimit, të mbajnë një marrëdhënie bashkëpunimi të hapur me prindërit; marrin përsipër, në mënyrë të veçantë, të sjellin në vëmendjen e prindërve përmbajtjen e Projektit edukativ të çerdes / shkollës. Pjesëmarrja e të gjithë prindërve garantohehet përmes takimeve formale (takime individuale, asamble të përgjithshme dhe asamble seksionesh, etj.) dhe raste takimesh joformale (festa, grupe pune me prindërit).

• **E DREJTA E PERSONELIT PËR LIRINË E MËSIMDHËNIES DHE FORMIMIT**

Mësuesve u jepet autonomi në planifikimin edukativ dhe didaktik; kjo autonomi shprehet brenda aktivitetit kolegjal të ekipit mësimor, në përputhje me udhëzimet e përfshira në legjislacionin kombëtar dhe rajonal, si dhe në udhëzimet dhe rregulloret komunale.

Planifikimi arsimor dhe didaktik i mësuesve mbështetet dhe promovohet nga aktivitete formimi të përhershme dhe të vazhdueshme. Përveç kësaj, i kushtohet kujdes trajnimit të stafit ndihmës, të cilët kontribuojnë, së bashku me mësuesit, në realizimin e projektit edukativ.

4. IDENTITÀ EDUCATIVA DEI SERVIZI EDUCATIVI E SCOLASTICI 0-6 ANNI

4. IDENTITETI EDUKATIV I SHËRBIMEVE ARSIMORE DHE SHKOLLORE 0-6 VJEÇ

Parime, udhëzime pedagogjike dhe qëllimi i shërbimeve

Çerdhja dhe kopshti i përgjigjen të drejtave të djemve dhe vajzave për edukim, shkollim dhe kujdes, në përputhje me parimet e pluralizmit kulturor dhe institucional të Kushtetutës së Republikës, Konventën për të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe dokumenteve të Bashkimit Evropian. Shërbimet komunale të kujdesit për fëmijët njohin dhe zbatojnë parimet e gjithëpërfshirjes, barazisë sociale, përgjegjësisë edukative të ndarë mes çerdhes-shkollës, familjes dhe komunitetit. Në nivelin pedagogjik, shërbimet i referohen vizionit të një fëmije të njohur si një qytetar që ka të drejta, si një protagonist aktiv në qendër të iniciativës edukative. Një fëmijë i konceptuar në tërësinë e tij, të zhvillimit dhe përvojës, brenda një edukimi koherente dhe unitar, në një perspektivë 0-6 vjeç.

Një fëmijë i mirëpritur dhe i vlerësuar për veçantinë e tij, duke i konsideruar dallimet individuale si një mundësi zhvillimi për të gjithë grupin e fëmijëve, gjendet brenda një perspektive përfshirëse. Familja njihet dhe vlerësohet si mjedisi i parë edukativ për fëmijët, dhe si një partner themelor në procesin shoqëruar të rritjes dhe edukimit të tyre.

Çerdhet dhe kopshtet kontribuojnë, së bashku me figurat e prindërve, në rritjen dhe trajnimin e djemve dhe vajzave dhe, në të njëjtën kohë, luajnë një rol në mbështetjen e familjeve. Shërbimet 0-6 vjeç kanë si qëllim të përbashkët, zhvillimin e potencialit për marrëdhënie, autonomi, kreativitet, mësim, në një kontekst të duhur emocional, lojërash dhe njohës.

Në mënyrë të veçantë, çerdhet, siç kërkohet nga legjislacioni rajonal, kanë për qëllim:

- trajnimin dhe shoqërimin mes fëmijëve, në perspektivën e mirëqenies së tyre psikofizike dhe zhvillimin e potencialit të tyre njohës, emocional, shoqëruar dhe shoqëror;
- kujdesi për fëmijët që kanë besimin e vazhdueshëm të figurave të ndryshme nga ato prindërore, në një kontekst të jashtëm nga ai familjar;
- mbështetje familjeve në procesin e kujdesit ndaj fëmijëve dhe në zgjedhjet edukative.

Kopshtet e fëmijëve, siç përcaktohen nga dokumentet kombëtare të referencës, kanë qëllimet e mëposhtme:

- të mbështesin proceset e ndërtimit dhe konsolidimit të identitetit të fëmijëve, të kuptuar si aftësia për të jetuar me qetësi të gjitha dimensionet e vetvetes, duke mësuar të njohin njëri -tjetrin dhe të njohin vetveten si një person unik dhe të papërsëritshëm;
- të zhvillojë autonominë e parë si një zhvillim progresiv i besimit tek vetja dhe tek të tjerët, aftësia për të shprehur ndjenjat, emocionet dhe opinionet personale, për të marrë pjesë në jetën e grupit dhe për të bërë zgjedhje;
- inkurajimin dhe përvetësimin e aftësive, të kuptuara si aftësia për të lëvizur, luajtur, manipuluar, shfletuar, kërkuar, pyetur, mësuar të reflektoni mbi përvojën, të shpreheni përmes përdorimit të gjuhëve të ndryshme;
- njohja e nocioneve të para të qytetarisë, ose më mirë zbulimi i tjetrit përmes vetes dhe nevojave të tij ose të saj, dhe përvetësimi progresiv i një sjelljeje të orientuar nga etika, duke respektuar të tjerët, mjedisin dhe natyrën.

Objektivat edukative të shërbimeve 0-6 vjeç ndiqen përmes projektimit dhe organizimit të qëllimshëm të një mjedisi cilësor të jetesës, marrëdhënieve dhe rrugëve mësimore dhe edukativo-didaktike të afta për të zhvilluar potencialin për rritje emocionale, njohëse, relacionale, sociale dhe kulturore të djemve dhe vajzave që i frekuentojnë.

Ky organizim garantohet nga profesionalizmi i të gjithë figurave që punojnë në këto shërbime dhe nga marrëdhëniet dialoguese me familjet dhe komunitetin.

Njohja e perspektivës 0-6 vjeç garantohet gjithashtu përmes bashkëndarjes së referencave teorike dhe metodologjike të zakonshme për çerdhet dhe kopshtet, nga një kordinim pedagogjik unitar dhe

nga përgatitja e një formimi të përbashkëta.

Organizimi i hapësirave, i materialeve, i kohës dhe marrëdhënieve

Mirëqenia, kujdesi dhe mësimi i fëmijës në çerdhe dhe kopsht arrihen përmes hartimit të një konteksti edukativ të përbërë nga hapësira, materiale, kohë dhe marrëdhënie të krijuara sipas nevojave specifike të grupmoshave të ndryshme.

Organizimi i hapësirës edukative merr parasysh nevojën për të kombinuar nevojën e fëmijës për intimitet / siguri emocionale me nevojën për eksplorim / zbulim.

Përveç kësaj, organizimi i qëllimshëm i hapësirës mbështet dhe promovon proceset e të mësuarit dhe ndihmon njohjen e shumëllojshmërinë dhe cilësinë e marrëdhënieve midis fëmijëve në mes tyre dhe midis të rriturve dhe fëmijëve.

Mjediset e çerdhes dhe kopshtit në përgjithësi përbëhen nga:

- hapësirat e seksioneve, të cilat përfaqësojnë vendin e privilegjuar të përkatësisë për fëmijët dhe janë krijuar në atë mënyrë që të marrin parasysh nevojat dhe moshat e tyre të ndryshme;
- hapësira për pushim;
- zona të përbashkëta (të tilla si sallë pritjeje, atelie, laborator, etj.);
- hapësira të jashtme, të pajisura me struktura lojërash;
- hapësira për të rritur dhe shërbime ndihmëse;
- hapësira e kuzhinës, e cila në çerdhe përdoret për përgatitjen e vakteve, ndërsa në kopshtin e fëmijëve për ndarje.

Koha shkollore kërkon një organizim të qëllimshëm, i cili merr parasysh nevojën e fëmijës për njohje, parashikueshmëri dhe referenca të qëndrueshme kohore, në mënyrë që të jetë gjithnjë e më aktive dhe autonom në kontekst.

Organizimi i kohës së përditshme përfshin gjithashtu nevojën për t'ju përgjigjur nevojave dhe interesave të individit dhe grupit, duke i balancuar ato me nevojat institucionale dhe organizative dhe duke identifikuar format më të përshtatshme të personalizimit.

Marrëdhëniet midis të gjithë atyre që "banojnë" në kontekstet edukative të çerdhes dhe kopshtit janë rezultat i një mendimi të përbashkët pedagogjik brenda grupit të punës; cilësia e tyre, një subjekt i vazhdueshëm reflektimi dhe monitorimi, konsiderohet një element themelor i një klime të favorshme për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rriturve. Strategjitë relacionale të edukatorëve dhe mësuesve bazohen në një qëndrim të kujdesit ndaj fëmijës ose grupit dhe kanë për qëllim promovimin e zhvillimit emocional, njohës dhe shoqëror.

Metodat edukative dhe didaktike

Një shumëllojshmëri metodash arsimore dhe didaktike janë të garantuara në çerdhe dhe kopshte, që synojnë zhvillimin e identitetit, autonomisë dhe potencialit të fëmijës në të gjitha fushat e kompetencës.

Propozimet edukative të çerdhes dhe kopshtit kanë një natyrë loje dhe eksperimentale. Ato vlerësojnë veprimin, eksplorimin, kontaktin me objektet, natyrën dhe mjedisin përreth.

Rrugët edukative dhe didaktike të hartuara duke filluar nga vëzhgimet e fëmijëve përfshijnë fushat shqisore, motorike, komunikuese, njohëse, ekspresive, relacionale dhe shoqërore, për një zhvillim harmonik të fëmijës.

Planifikimi në kopshtet komunale, si shkolla të barabarta, i referohet "Udhëzimeve kombëtare për kurrikulën e kopshteve", të cilat identifikojnë pesë fusha të përvojës:

- vetja dhe tjetri;
- trupi dhe lëvizja;
- imazhet, tingujt, ngjyrat;
- fjalimet dhe fjalët;

- njohja e botës.

Çdo fushë e përvojës ofron një sërë objektesh, situatash, imazhesh dhe gjuhësh, që i referohen sistemeve simbolike të kulturës sonë, të afta për të evokuar, stimuluar, shoqëruar mësimin në mënyrë progressive. Planifikimi i shkollave, për më tepër, karakterizohet nga një hapje ndaj territorit, e menduar si një burim edukativ dhe didaktik dhe për një vlerësim të artit si një mjet edukativ për të përforcuar burimet e veta emocionale dhe imagjinare të dobishme për të lehtësuar të kuptuarit e vetes, të të tjerëve dhe botës.

Në kopshtin e fëmijëve, për ata që e kërkojnë, ofrohet mësimi i fesë katolike.

Për fëmijët që nuk përfitojnë nga kjo mundësi, janë në dispozicion aktivitete alternative edukative-didaktike.

Momente të "rutinës"

Rutinat, momentet e përditshme të kujdesit, intimitetit, marrëdhënieve (mikpritja, vakti, kujdesi për trupin, pushimi, ribashkimi ...) marrin një rëndësi të veçantë në organizimin e kontekstit edukativ të çerdhës dhe kopshtit.

Për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, në fakt, dimensionin e kujdesit ka një konotacion të fortë lidhës dhe njohës.

Përmes rutinave, fëmija mëson të vendosë veten në një dimension hapësirë - kohë, duke parashikuar ngjarjet dhe përjeton strategjitë relacionale dhe njohëse që i lejojnë atij të lidhet me të tjerët dhe mjedisin përreth.

Në jetën e përditshme, momentet rutinë alternohen në një mënyrë të qëllimshme me momente të lojës së vetëorganizuar ose të drejtuar dhe me propozime edukative dhe didaktike, në mënyrë që fëmija të gjejë një strukturë të qëndrueshme dhe të parashikueshme të ditës për të lehtësuar dhe mbështetur marrjen e autonomisë.

Organizimi i grupeve të fëmijëve

Edukatorët dhe mësuesit vlerësojnë dimensionin e grupit dhe inkurajojnë bashkëpunimin midis fëmijëve si një element themelor të marrëdhënieve edukative.

Grupi seksion është referenca kryesore për fëmijën që ndjekin çerdhen ose kopshtin dhe për këtë arsye kujdeset për stabilitetin e tij, duke siguruar një vazhdimësi në kohë. Këto referenca favorizojnë vazhdimësinë e përvojës dhe mbështesin krijimin progresiv të ndjenjës së përkatësisë që ndihmon në forcimin e sigurisë emocionale të fëmijës dhe rritjen e potencialit të grupit.

Aktivitetet e grupit të vogël dhe të madh në fillim planifikohen e pastaj zbatohen. Përbërja dhe lloji i grupit vendoset nga edukatorët / mësuesit, në lidhje me objektivat e parashikuara nga planifikimi arsimor dhe njohuritë e fëmijëve, por ato gjithashtu mund të krijohen edhe nga një organizim spontan.

Për më tepër, krijohen momente të bashkëpunimit të fëmijëve për të zgjeruar mundësitë për shoqërim dhe mësim për djemtë dhe vajzat.

Ambienti

Ambienti është një moment veçanërisht i rëndësishëm për pjesëmarrjen pozitive të fëmijës në çerdhe / kopsht. Për këtë arsye, ekipet edukative zhvillojnë një projekt specifik, i cili ndahet edhe me prindërit.

Për të promovuar **mirëqenien** e fëmijëve, projekti i ambientimit për çerdhet dhe kopshtet karakterizohet nga vëmendja për aspektet e mëposhtme:

- gradualiteti si në kohën e kaluar në shërbim ashtu edhe në shpërndarje nga figura prindërore;
- rregullsia e frekuentimit gjatë gjithë fazës së ambientimit;
- organizimi në grupe të vogla;

- organizimi i kontekstit, duke iu referuar veçanërisht momenteve të tranzicionit familje-çerdhe / shkollë;
- pjesëmarrja dhe aleanca edukative me familjet.

Puna e ekipit

Përqendrimi i punës në grup është një element kualifikues i historisë dhe identitetit të çerdheve dhe kopshteve komunale. Kjo zgjedhje i referohet një konceptimi bashkëpunues të veprimtarisë arsimore, brenda së cilës vendoset dhe vlerësohet kontributi origjinal i profesionistëve. Të gjithë figurat që punojnë në çerdhe dhe kopsht kryejnë një funksion edukativ.

Praktika e grupit të punës bazohet në kolegjalitet. Kolegjialiteti favorizon integrimin dhe qëndrueshmërinë e brendshme në nivel grupi dhe shërbimi, promovon krahasimin midis këndvështrimeve të ndryshme dhe mbështet punën e operatorëve të përfshirë.

Grupi i punës ka një rol qendror në organizimin e kontekstit arsimor dhe në përgatitjen, planifikimin dhe dokumentacionin arsimor.

Projektimi

Identiteti pedagogjik dhe projektues i shërbimeve gjen shprehje në Projektin Pedagogjik, një dokument themelor që përcakton fizionominë e përgjithshme të shërbimeve edukative të fëmijëve 0-6 vjeç.

Grupi i edukatorëve / mësuesve, së bashku me kordinatorin pedagogjik referues, artikulojnë dhe zhvillojnë Projektin pedagogjik sipas projektit edukativ të secilës çerdhe / shkollë.

Në Projektin edukativ, zgjedhjet didaktike (metodologji specifike, mjete, metoda organizative, etj ...) dhe aktivitetet e projektit, të cilat karakterizojnë ofertën e trajnimit të secilit shërbim, identifikohen dhe shpjegohen në lidhje me situatat konkrete.

Në bazë të projektit edukativ, edukatorët / mësuesit zhvillojnë Projektin vjetor të seksionit / ndërseksionit.

Në të gjitha nivelet e planifikimit pedagogjik-edukativ, dallimet personale, kulturore dhe etnike të fëmijëve njihen dhe vlerësohen.

Si pjesë e një projekti shkollor gjithëpërfshirës të aftë për të njohur, mirëpritur dhe rritur diversitetin e individëve, shërbimet komunale të kujdesit për fëmijët garantojnë integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me disavantazhe sociale dhe kulturore.

Për këtë qëllim, hartohen projekte të individualizuara, të lidhura me projektin e seksionit.

Për të mbështetur integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (të dokumentuar dhe çertifikuar nga shërbimet kompetente) në çerdhet dhe kopshtet, masat e mëposhtme janë parashikuar, në lidhje me nevojat aktuale të identifikuar dhe burimet në dispozicion:

- aktivizimi i ndërhyrjeve edukative dhe mbështetëse didaktike përmes caktimit të figurave të veçanta profesionale;

- blerja e pajisjeve dhe materialeve dhe / ose mjeteve specifike mësimore, të cilat, në çdo rast, duhet të lidhen me nevojat e projektit individual.

Për fëmijët që gjenden në situata të veçanta të vështirësive ose disavantazheve socio-kulturore të njohura nga shërbimet sociale lokale, shërbimet arsimore zbatojnë masa të veçanta organizative, të lidhura me nevojat e fëmijëve dhe seksionit.

Vlerësimi

Vlerësimi përbën një element të pashmangshëm të cilësisë së një shërbimi arsimor dhe është një proces ku marrin pjesë të gjithë ata që janë përfshirë.

Periodikisht nga ekipet ndërmirren aktivitete të vetëvlerësimit, përmes proceseve dhe mjeteve në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe rajonale mbi këtë temë. Këto aktivitete kanë për qëllim

promovimin e përmirësimit e vazhdueshëm të punës arsimore dhe zhvillimit profesional të operatorëve.

Parashikohen momente specifike të dhënies së rezultateve të vlerësimit familjeve dhe administratorëve.

Për më tepër, parashikohen sondazhe periodike të cilësisë të bëra nga familjet, përmes instrumenteve të veçanta dhe momenteve të veçanta institucionale.

Formimi

Institucioni tenton të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme nivelin e aftësive profesionale dhe përgatitjen e stafit të tij, përmes kurseve të veçanta të trajnimit.

Trajnimi në shërbim i operatorëve (edukatorë, mësues, bashkëpunëtorë arsimorë, kuzhinierë, kordinatorë pedagogjikë) ndihmon në pasurimin e profilit profesional të një operatori kompetent, i aftë të kalibrojë ndërhyrjen e tij në lidhje me grupmoshat e ndryshme dhe specifikat e fëmijëve dhe familjeve.

Për këtë qëllim, pasi dëgjohen nevojat dhe vlerësohen propozimet që vijnë nga grupet e punës, kordinimi pedagogjik përgatit një plan vjetor trajnimi që parashikon pjesëmarrjen e të gjithë stafit në sesionet e trajnimit sistematik. Plani i trajnimit është në dispozicion të prindërve për shikim.

Vazhdimësia

Shërbimet arsimore dhe shkollore 0-6 vjeç të Bashkisë Forli bashkëpunojnë me familjet dhe agjencitë e tjera arsimore në zonë, në një perspektivë të një komuniteti edukativ që vlerëson qëllimin, ndërlidhjen dhe bashkë-përgjegjësinë midis subjekteve të ndryshme të përfshira në procesin e edukimit, me kapacitete të ndryshme dhe me role të ndryshme.

Vëmendje e veçantë i kushtohet lidhjes dhe rrjetëzimit me shërbimet shëndetësore dhe sociale lokale.

Për më tepër, aksione specifike promovohen në mbështetje të vazhdimësisë edukative midis institucioneve arsimore dhe shkollore. Duke pasur parasysh kalimin nga çerdhja në kopsht dhe nga kopshti në shkollën fillore, janë parashikuar forma të veçanta të bashkëpunimit mes edukatorëve dhe mësuesve për të shkëmbyer informacion mbi rritjen e përvojave arsimore që realizojnë djemtë dhe vajzat, në mënyrë që të përgatitet më mirë pritja e secilit fëmijë në kontekstin e ri shkollor, duke siguruar një kalim sa më gradual dhe pozitiv.

5. RUOLI E PROFESSIONALITË

5. ROLET DHE PROFESIONALIZMI

Operatorët dhe profesionistët

Për funksionimin e shërbimeve edukative sigurohet prania e figurave profesionale specifike në përputhje me parametrat e vendosur nga legjislacioni aktual.

Stafi zgjidhet nga zyrat kompetente të Komunës përmes momenteve të konfrontimit me Kordinimin Pedagogjik në mënyrë që të sigurohet funksionaliteti i organizmit për nevojat edukative dhe didaktike të çerdhes dhe kopshtit.

Profesionistët që punojnë në kuadër të shërbimeve komunale edukative dhe shkollore janë:

- edukatorët / edukatoret dhe mësuesit
- bashkëpunëtorët dhe bashkëpunëtoret arsimorë/e
- operatorët dhe operatoret e kuzhinës
- dietologu/ja
- kordinatorët dhe kordinatoret pedagogjike / e.

Ekzistojnë gjithashtu figura specifike profesionale për shërbimin atelie, një shërbim që pasuron ofertën formative të shërbimeve komunale për fëmijët.

Komuna përdor figura të veçanta profesionale për mbështetje edukative dhe didaktike në prani të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Së fundi, figura e mësuesit për fenë katolike në kopshtin e fëmijëve është e garantuar, bazuar në legjislacionin aktual.

Të gjithë operatorët thirren të kryejnë, sipas profesionalizmit dhe roleve të ndryshme, një funksion të përbashkët edukativ.

E gjithë kjo kërkon investime të vazhdueshme në proceset e trajnimit dhe kualifikimit të personelit dhe një përcaktim të funksioneve dhe roleve profesionale në përputhje me qëllimin e shërbimeve. Planet e trajnimit dhe kualifikimit për stafin, duhet të sigurojnë një studim të thelluar si të aftësive specifike të roleve të ndryshme, ashtu edhe në zhvillimin e njohurive themelore pedagogjike dhe metodologjike-edukative.

Në shërbimet edukative dhe shkollore është e mundur të sigurohet prania e studentëve të trajnuar dhe e vullnetarëve të shërbimit civil.

Edukatorët / Edukatorët dhe mësuesit

Në kontekstin e funksionit të përbashkët arsimor, në veçanti, roli i edukatorëve / mësuesve bazohet në parimin e autonomisë kulturore dhe profesionale, e cila shprehet në veprimtaritë individuale dhe kolegjiale në lidhje me:

- planifikimin arsimor;
- organizimi i propozimeve edukative-didaktike, të momenteve të kujdesit dhe rutinës;
- pjesëmarrja në momentet e rikualifikimit dhe trajnimit gjatë shërbimit.

Prandaj, edukatorët / mësuesit kanë për detyrë dhe përgjegjësi të planifikojnë dhe zbatojnë, në mënyrë kolegjiale, planin edukativ e arsimor, që synon nxitjen e zhvillimit njohës, afektiv, social dhe kulturor të secilit fëmijë, në bazë të qëllimeve dhe objektivave të parashikuara nga udhëzimet (kombëtare, rajonale dhe komunale) të sektorit dhe nga Projekti pedagogjik.

Brenda kuadrit të përcaktuar nga Projekti Pedagogjik dhe Projekti Edukativ, në veçanti, edukatorët / mësuesit zhvillojnë, zbatojnë dhe verifikojnë në mënyrë kolegjiale, si në ekipin e seksionit ashtu edhe brenda ekipit të çerdheve / shkollave, programimin e propozimeve arsimore, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme të fëmijëve dhe kontekstit specifik social dhe kulturor të referencës.

Bashkëpunëtorët / bashkëpunëtorët arsimorë

Bashkëpunëtorët arsimorë janë pjesë e ekipit arsimor dhe kryejnë funksionet e mëposhtme:

- bashkëpunojnë me stafin arsimor për zbatimin e aktiviteteve edukative dhe didaktike, përfshirë momentet e rutinës, brenda afateve të parashikuara në projektin arsimor, sipas metodave të zgjedhura brenda ekipit arsimor;
- përgjigjen për higjienën e lokaleve, orendive dhe pajisjeve me vëmendje të veçantë ndaj rregullave të shëndetit dhe higjienës në fuqi dhe detyrimeve përkatëse;
- sigurojnë kujdesin dhe ruajtjen e pajisjeve dhe bashkëpunojnë në mirëmbajtjen e materialeve mësimore;
- kryejnë aktivitetet që lidhen me ndarjen, shpërndarjen dhe ndihmën në momentin e ngrënies;
- përgjigjen për aktivitetet që lidhen me guardarobën dhe lavanderinë;
- bashkëpunojnë me personelin mësimor për mbikëqyrjen e të miturve.

Punëtorët dhe punëtorët e kuzhinës

Punëtorët dhe punëtorët e kuzhinës janë pjesë e ekipit arsimor. Gjatë orarit të punës:

- bashkëpunojnë me figurën e Dietologut në hartimin e tabelave dietike, po ashtu në planifikimin dhe kryerjen e aktiviteteve të edukimit ushqimor dedikuar familjeve, në verifikimin e pëlqimit të menusë nga ana e fëmijëve;

- bashkëpunojnë me stafin e çerdhes për të krijuar momente edukative për fëmijët, të lidhura me ushqimin;
- gatujnë ushqime sipas menisë dhe gramaturës së përcaktuar, duke vepruar në përputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni higjieno - shëndetësor dhe të procedurave të përfshira në planin e vetëkontrollit të bazuar në parimet e sistemit HACCP;
- sigurojnë blerjen e ushqimit të nevojshëm për përgatitjen e vakteve, kontrollojnë cilësinë e tij, që duhet të korrespondojë me atë të kërkuar nga skedat merceologjike të paraqitura dhe të pranuar nga furnizuesit gjatë tenderit, si edhe sasinë. Kontribuojnë, në përputhje me metodat e dakorduara brenda ekipit arsimor, në mbledhjen e faturave në lidhje me ushqimin e blerë dhe verifikimin e tyre.

Dietologu

Kordinimi i qendrave të gatimit të kopshteve i është besuar figurës së Dietologut i cili ka për detyrë promovimin e dhënies të një shërbimi që i përgjigjet standarteve të sigurisë dhe të cilësisë, në përputhje me legjislacionin aktual dhe zbatimin, në bashkëpunim me ekipin arsimor të secilës çerdhe, për të krijuar strategji të përshtatshme drejt një afrimi të këndshme të fëmijës ndaj një diete të duhur.

Në lidhje me këtë funksion, Dietologu kryen detyrat e krijimit të bashkëpunimit midis kuzhinave të kopshteve, drejtimin dhe mbështetjen teknike në punën e punëtorëve të kuzhinës, planifikimin e aktiviteteve të trajnimit dhe eksperimentimit, duke promovuar kështu kualifikimin e të ushqyerit në çerdhe.

Ai/ajo është personi referent për aspektet ushqimore që lidhen me shërbimin dhe menaxhimin e planit të vetëkontrollit dhe të aktiviteteve që synojnë verifikimin e përputhshmërisë me rregullat mbi higjienën e ushqimit në fazat e ndryshme të ciklit të prodhimit.

Ai/ajo kontribuon në hartimin e kurseve të edukimit ushqimor për fëmijët si pjesë e aktiviteteve të çerdheve, ofron dhe kordinon momente të veçanta trajnimi për familjet.

Kordinatorët / kordinatoret pedagogjikë

Prania e figurave të kordinimit pedagogjik është e garantuar në lidhje me numrin e shërbimeve, të organizuara në një ekip kordinues pedagogjik që garanton koherencën, efektivitetin dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve.

Kordinatorët pedagogjikë kryejnë këto funksione:

- kryerjen e organizimit të brendshëm të shërbimit arsimor;
- pjesëmarrjen në përcaktimin e projektit arsimor, në monitorimin-verifikimin dhe dokumentimin e zbatimit të tij;
- planifikimin dhe organizimin e trajnimit të operatorëve;
- promovimin e njohurive dhe të sinergjisë midis shërbimeve arsimore, sociale dhe shëndetësore, si një komunitet edukues;
- planifikimin e aktiviteteve për mbështetjen e prindërve;
- lehtësimin dhe mbështetjen e grupit të punës, mbështetjen teknike dhe udhëzimet mbi punën e operatorëve;
- planifikimin dhe mbështetjen për ndërhyrjet që synojnë, në veçanti, integrimin dhe përfshirjen e fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore;
- kujdesin për koherencën e dokumenteve të ndryshme me aspekte metodologjike dhe udhëzimet arsimore të shërbimit të përfshira në projektin pedagogjik;
- organizimin e praktikave për vlerësimin e cilësisë arsimore të shërbimit.

Mënyra e punës:

Grupi i punës i edukatorëve / mësuesve (ekipi i edukatorëve / mësuesve)

Të gjithë edukatorët / mësuesit që punojnë brenda çdo çerdheje / shkolle përbëjnë një grup (ekip) të vetëm pune i cili takohet periodikisht, sipas procedurave të përcaktuara në Projektin pedagogjik, me pjesëmarrjen, në momentet e caktuara, të kordinatorit pedagogjik.

Grupi i punës i edukatorëve / mësuesve, në bashkëpunim me kordinatorin referent:

- përpunon *Projektin edukativ të çerdhes / shkollës* dhe planifikimin edukativo-didaktik;
- identifikon, në veçanti, format dhe mjetet për verifikimin dhe vlerësimin e rezultateve të ndërhyrjes edukative dhe metodat e zbatimit të saj.

Edukatorëve / mësuesve të seksionit u është besuar përcaktimi i planifikimit arsimor dhe didaktik, përpunimi dhe artikulimi i aktiviteteve dhe verifikimi përkatës, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në *Projektin arsimor*.

Grupi i punës i edukatorëve / mësuesve, në marrëveshje me kordinatorin pedagogjik, planifikon mënyrat e paraqitjes së aktiviteteve arsimore familjeve dhe modalitetet e pjesëmarrjes të këtyre në jetën e çerdhes / shkollës. Grupi i punës gjithashtu pranon të marrë pjesë në projekte kërkimore - formative dhe eksperimentale.

Grupi i punës arsimor (ekipi arsimor)

Grupi i punës arsimor (ekipi arsimor) përbëhet nga të gjithë operatorët (edukatorët / mësuesit, personeli ndihmës dhe i kuzhinës, kordinatori pedagogjik) i çerdhes / shkollës.

Ai mbledhet rregullisht për organizimin dhe verifikimin e shërbimit.

Stafi përgjegjës merr pjesë në aktivitetet e ekipit brenda mënyrave të dakorduara.

Grupi i punës arsimor përcakton çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve të çerdheve / shkollave, në lidhje me çështjet edukative, duke vendosur gjithashtu metodat e pjesëmarrjes së bashkëpunëtorëve dhe bashkëpunëtorëve arsimore në aktivitetet edukativo-didaktike.

Janë përcaktuar takime të rregullta me kordinatorin pedagogjik dhe, kur është e nevojshme, me drejtuesit e zyrave të Shërbimit Kompetent Komunal.

Grupet e punës në bazë të projekteve

Aktiviteti i personelit që punon në çerdhe dhe shkolla mund të krijojë gjithashtu grupe të punës të bazuara në projekte, të cilat mund të formohen nga edukatorët / mësues, ose nga edukatorë / mësues dhe bashkëpunëtorët edukativë (në disa raste duke siguruar edhe praninë e stafit të kuzhinës) të të njëjtës çerdhe / shkollë ose të çerdheve / shkollave të ndryshme, në prani ose jo të kordinatorëve pedagogjikë, në varësi të qëllimeve për të cilat janë krijuar (p.sh. : trajnimi, rishikimi i dokumenteve, hulumtime, projektet evropiane ...).

Ndërekipe

Janë parashikuar metoda të punës ndërekimore të cilat, në bazë të temave të trajtuara, sigurojnë përfaqësimin e figurave të ndryshme profesionale dhe praninë e kordinatorëve pedagogjikë dhe të Drejtorisë pedagogjike.

Ndërekipi i edukatorëve / mësuesve zakonisht përbëhet nga një edukator / mësues për çdo çerdhe ose kopsht (dy për çerdhet dhe shkollat me më shumë se tre seksione) dhe nga kordinatorë pedagogjikë.

Ndërekipi arsimor përbëhet nga përfaqësues të edukatorëve / mësuesve dhe përfaqësues të bashkëpunëtorëve arsimorë dhe stafit të kuzhinës.

Përgjegjësit organizativë

Organizimi, funksionimi dhe menaxhimi administrativ i shërbimeve arsimore garantohej nga zyrat komunale përgjegjëse. Në veçanti, ata janë përgjegjës për:

- aktivitetin që synon përcaktimin e fuqisë punëtore dhe menaxhimin e stafit;

- aktivizimin dhe kryerjen e procedurave për pranimin e të miturve;
- mbajtjen e raporteve me familjet në lidhje me menaxhimin e shërbimit (tarifat, transferimet, heqjet dorë, etj.).

Zyrat gjithashtu kryejnë detyrat e mëposhtme:

- planifikojnë dhe garantojnë, në bashkëpunim me shërbimet kompetente:
 - Ndërhyrjet për mirëmbajtjes e komplekseve shkollore;
 - Procedurat dhe aktet në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen në vendin e punës;
 - aplikimet dhe ruajtjet e normave higjieno - shëndetësore;
- zhvillojnë lidhjet me organizmat pjesëmarrëse;
- kryejnë furnizimet dhe kontrollin e kostove të shërbimeve;
- kontrollojnë dhe monitorojnë cilësinë e menaxhimit dhe ndryshimet kryesore organizative të shërbimeve, në mënyrë që të identifikojnë, në kohën e duhur, çështjet kritike dhe ti korrigjojnë në kohë.

6. L'ORGANIZZAZIONE DEL NIDO D'INFANZIA

6. ORGANIZIMI I ÇERDHES

Kujt i drejtohet

Të gjithë fëmijëve të moshës nga 3 deri në 36 muaj në përputhje me normat në fuqi në fushën sanitare. Prioritet u jepet fëmijëve rezidentë, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve nën kujdesin e shërbimit social, edhe nëse nuk janë rezidentë. Administrata komunale miraton dhe publikon kriteret e përzgjedhjes / pranimit dhe procedurat e regjistrimit.

Periudha dhe oraret e hapjes

Çerdhet janë të hapura nga shtatori deri në qershor. Gjatë vitit, periudhat e pezullimit të aktiviteteve arsimore janë në përshtatje me kalendarin shkollos rajonal.

Në korrik, janë planifikuar zgjatje gjatë periudhës verore në disa komplekse, të organizuara në lidhje me kërkesën aktuale të kujt ka nevojë dhe të rezervuara për familjet në të cilat prindërit (ose prindi i vetëm) janë të angazhuar në punë.

Çerdhet janë të hapura pesë ditë në javë, nga e hëna në të premte, nga ora 7.30 në orën 18.30. Brenda kësaj periudhe, vlerësohen nevojat e kërkuarve dhe bëhet programimi i përgjithshëm i shërbimit:

- çerdhet me orar të zgjatur (7.30 / 18.30)

(për fëmijët nën moshën një vjeç, qëndrimi gjatë pasdites lejohet deri në orën 16:30)

- çerdhet me orar të shkurtuar (7.30 / 16.00)

Hyrjet dhe daljet e ndryshme përcaktohen brenda orarit të hapjes së shërbimit.

Përdorimi i shërbimit nga ora 16:00 deri në 18:30 është i rezervuar për familjet në të cilat prindërit (ose prindi i vetëm) janë të angazhuar në aktivitete pune pasdite.

Shërbimi i zgjatjes së orarit të pasdites dhe atij veror kryhen me kontratë nga ndërmarrje që punësojnë personel të kualifikuar, si pjesë e një projekti të përbashkët arsimor.

Seksionet

Kopshtet janë të ndara në seksione. Seksioni përfaqëson bërthamën organizative bazë dhe kontekstin përkatës të privilegjuar për fëmijët. Çerdhet komunale janë të strukturuar në një numër seksionesh që mund të shkojnë nga 1 në 4.

Numri i fëmijëve për çdo seksion përcaktohet në bazë të moshës së tyre, të karakteristikave strukturore të shërbimit, të raportit numerik midis stafit dhe fëmijëve të regjistruar sipas rregulloreve rajonale në fuqi.

Përbërja e grupit të seksioneve është zakonisht homogjene sipas moshës, për fëmijët nga 3 deri në 12 muaj dhe heterogjene për fëmijët më të mëdhenj. Në përcaktimin e seksioneve heterogjene, vëmendje i kushtohet ekuilibrit të grupmoshave të ndryshme.

Seksionet përcaktohen, nga viti në vit, në fund të regjistrimeve, bazuar në moshën e fëmijëve që aplikojnë për pranim në çerdhe.

Ambientimi

Cilësia e mjedisit është thelbësore për frekuentimin pozitiv të çerdes nga fëmijët; për këtë arsye, ekipet arsimore paraqesin një projekt specifik, të bashkëndarë me prindërit me rastin e Asamblesë së anëtarëve të rinj.

Fëmijët e rinj të regjistruar

Ambientimi i fëmijës së ri të regjistruar bëhet në grupe të vogla, me data të ndryshme fillimi, sipas një kalendari të vendosur gjatë Asamblesë së të sapo regjistruarve.

Parashikohet një periudhë graduale në kohën e qëndrimit dhe të shkëputjes nga figura e prindërve.

Normalisht, ambientimi i një seksioni përfundon brenda 6 javëve nga hapja e kopshtit.

Ambientimi i fëmijës, përballë një vazhdimësie të frekuentimit, bëhet si më poshtë:

- Në ditët e para, frekuentimi është i pjesshëm (duke filluar nga një orë) dhe kërkohet prania, sipas kohës dhe metodave të dakorduara me edukatorët, e njëjës nga figurat prindërore, ajo që mund të garantojë vazhdimësi gjatë kësaj periudhe. Kjo prani është planifikuar për të paktën tre ditë, por mund të zgjatet nëse është e nevojshme. Figura prindërore garanton, prezencën edhe për ditët në vijim, deri në përfundimin e ambientimit.
- Normalisht gjatë javës së parë të frekuentimit të fëmijës, koha e kaluar në çerdhe gradualisht rritet për të përfshirë kohën e vaktit.
- Brenda javës së dytë, si rregull, propozohet koha e pushimit të pasdites (për ata që qëndrojnë në kopësht edhe pas orës 13:00).

Përafërsisht pas një jave dalje brenda orës 16.00, është e mundur për ata që e kërkojnë, të shtojnë orarin e pasdites.

Për fëmijët e moshës nga 3-12 muajsh, momenti i gjumit të pasdites parashikohet duke filluar nga java e tretë, me përjashtim të situatave të veçanta, kur bihet dakord me edukatorët.

Për të lehtësuar angazhimet e prindërve në marrëdhënie pune, koha e ambientimit trajtohet në mënyrë elastike, me metoda të individualizuara, duke respektuar mirëqenien e fëmijës.

Në seksionet ku ka fëmijë që ndjekin nga viti i kaluar, anëtarët e rinj fillojnë ambientimin pas "riambientimit" të fëmijëve që ndjekin nga vitet e mëparshme.

Fëmijët që frekuntorin edhe vitet e mëparshme

Për fëmijët që frekuntojnë nga viti i kaluar, parashikohet një periudhë e kushtuar "riambientimit", që synon të rindërtojë grupin e seksionit dhe të forcojë rrethanat hapësinore dhe relacionale pas pushimeve verore.

Normalisht rehabilitimi bëhet, sipas kohës së mëposhtme:

- Në pesë ditët e para, frekuntojnë deri në orën 13.00
- Nga dita e gjashtë propozohet gjumi i pasdites dhe qëndrimi është i mundur deri në orën 16.00.
- Nga dita e shtatë është i mundur qëndrimi me orar të plotë (deri në orën e kërkuar).

Fëmijët e transferuar nga shërbimet e tjera arsimore

Ambientimi i fëmijëve të transferuar nga shërbimet e tjera arsimore zakonisht bëhet pas riambientimit të fëmijëve që kanë ndjekur nga viti i kaluar dhe bëhet pak a shume në tre ditë. Prania e prindit është caktuar për ditën e parë, por mund të zgjatet në lidhje me vlerësimet specifike të akorduara me edukatorët.

Gjatë fazës së ambientimit të fëmijëve të rinj të regjistruar ose atyre të transferuar nga shërbimet

e tjera, janë parashikuar takime mes edukatorëve dhe prindërve për një shkëmbim informacionesh mbi historinë e fëmijës dhe mbi organizimin e shërbimit.

Organizimi i stafit

Për funksionimin e çerdheve, sigurohet prania e njësive të personelit arsimor, të bashkëpunëtorëve arsimorë dhe stafit të kuzhinës, në përputhje me parametrat e parashikuar nga legjislacioni aktual rajonal. Stafi zgjidhet nga zyrat kompetente të Bashkisë përmes momenteve të konfrontimit me Kordinimin Pedagogjik në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e punës për të përmbushur nevojat arsimore dhe didaktike të çerdheve. Në prani të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe në lidhje me nevojat specifike, garantohen masa të përshtatshme në lidhje me numrin e edukatorëve dhe metodat organizative. Garantohen zëvendësimet në rast të mungesës së personelit, duke marrë parasysh nevojat e shërbimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit rajonal, në linjë me kontratën kolektive kombëtare të punës dhe të akordeve të firmuara.

Menaxhimi i shërbimeve mbështetëse arsimore, të zgjatjes së orarit të pasdites dhe veror u besohen palëve të treta, në një logjikë të integritit dhe dialogut të vazhdueshëm që synon të garantojë vazhdimësinë dhe koherencën e shërbimit në tërësi.

Një ditë e zakonshme

Dita e zakonshme në çerdhe zhvillohet si më poshtë:

7.30 - 9.00: hyrja e fëmijëve

9.00 - 9.30: frutat

9.30 - 10.45: aktivitete lojërash, propozime edukative ose pushim, në varësi të moshës

10.45 - 11.15: përgatitje për drekën

11.15-12: dreka

12.00 - 12.30: lojëra dhe përgatitje për dalje ose pushim

12.30 - 13.00: dalja e parë

12.30 - 15.00: pushim dhe zgjim

15.00-15.30: zamër

15.30 - 16.00: dalja e dytë

Zgjatja e orarit të pasdites (çerdhe me kohë të zgjatur)

16.00 - 18.30: lojëra dhe dalja e tretë

Ushqimi

Çdo çerdhe është e pajisur me një pikë gatimi të brendshëm, të pajisur dhe autorizuar nga Ndërmarrja U.S.L., në të cilën punon personeli i nevojshëm për të siguruar funksionimin e saj. Objektivi kryesor i shërbimit është t'u ofrojë fëmijëve që ndjekin çerdhen një vakt të sigurt nga pikëpamja higjienike, të balancuar nga pikëpamja ushqyese dhe të këndshëm për sa i përket cilësive organoleptike.

Në lidhje me cilësinë e lëndëve të para, parashikohet përdorimi i produkteve organike të certifikuara, pa organizma të modifikuar gjenetikisht.

Objektivi kryesor i shërbimit është të orientojë fëmijën drejt një ushqimi të duhur, të larmishëm dhe të ekuilibruar, duke përfshirë edhe familjet në problemin "ushqyes".

Projekti ushqyes në çerdhe përfshin:

- një moment ngrënie të bazuar në fruta të freskëta të stinës në pjesën e parë të mëngjesit;
- dreka e përbërë nga një pjatë e parë dhe e dytë ose, përndryshe, nga një pjatë e vetme e përbërë nga karbohidrate dhe proteina shtazore ose bimore, një kontorno me perime të ziera dhe / ose të gjalla të stinës, bukë dhe fruta të freskëta sezonale;
- zamër.

Përgatitja e vakteve bëhet duke ndjekur menunë e ditës të shënuar në tabelën dietike, të përgatitur nga dietologu përgjegjës për qendrat e gatimit të çerdheve dhe të miratuar nga shërbimi kompetent i Ndërmarrjes U.S.L.

Tabela dietike është hartuar në përputhje me të dhënat e marra nga Linjat udhëzuese në lidhje me peshën e ushqimeve, shpeshtësinë e konsumimit dhe kombinimit të pjatave.

Pikat e gatimit të çerdheve garantojnë aplikimin e dietave të veçanta për nevojat e veçanta klinike të përdoruesve dhe të dietave të kërkuara nga familjet për arsye etiko-fetare ose kulturore.

Në rastet e parashikuara nga ligji, ushqimet mund të përgatiten në struktura jashtë çerdheve dhe në përputhje me praktikën higjienë - shëndetësore.

7. L'ORGANIZZAZIONE DELLA SCUOLA DELL' INFANZIA

7. ORGANIZIMI I KOPSHTIT TË FËMIJËVE

Kujt i drejtohet

Në kopshte mund të pranohen të gjithë fëmijët midis moshës tre dhe gjashtë vjeç në përputhje me rregulloret shëndetësore në fuqi. Prioritet u jepet fëmijëve rezidentë, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve për të cilët kujdeset shërbimi social, edhe nëse ata janë jorezidentë. Administrata komunale miraton dhe publikon kriteret e përzgjedhjes / pranimit dhe procedurat e regjistrimit.

Periudha e hapjes dhe oraret

Kopshtet funksionojnë nga shtatori deri në qershor. Gjatë vitit, ka periudhat të pezullimit të aktiviteteve arsimore sipas kalendarit shkollor rajonal. Kopshtet janë të hapura pesë ditë në javë, nga e hëna në të premte, në një orar që shkon nga ora 7.30 në 18.30. Përdorimi i shërbimit nga ora 14:30 deri në 18:30 është i rezervuar për familjet në të cilat prindërit (ose prindi i vetëm) janë në marrëdhënie pune pasdite. Në muajin korrik, mund të bëhen zgjatje për periudhën verore, në lidhje me kërkesën aktuale të kërkuarësve. Përdorimi i shërbimit të kohëzgjatjes verore është i rezervuar për familjet në të cilat prindërit (ose prindi i vetëm) janë të angazhuar në punë.

Shërbimi i kohëzgjatjes së pasdites dhe gjatë verës menaxhohet me kontratë nga ndërmarrje që punësojnë personel të kualifikuar, si pjesë e një projekti të përbashkët arsimor.

Seksionet

Modeli organizativ i shkollave komunale është i lidhur ngushtë me identitetin pedagogjik të kopshtit, si një segment i jetës shkollore të fëmijës që, në një logjikë të vazhdimësisë 0 - 6 vjeç, mbulon grupmoshën 3 - 6 vjeç. Kopshtet komunale normalisht janë të strukturuar në seksione deri në 25 fëmijë, të cilët mund të bëhen 26 në prani të një fëmije me aftësi të kufizuara, duke siguruar aktivizimin e ndërhyrjeve mbështetëse edukative-didaktike përmes caktimit të figurave të veçanta profesionale. Ka kopshte me tre ose gjashtë seksione, zakonisht homogjene sipas moshës, ose me dy seksione, heterogjene sipas moshës. Në nivelin e një shkolle të vetme, mund të parashikohen si pjesë e planifikimit edukativo-didaktik aktivitete të ndërthurura.

Në shkollat me gjashtë seksione, në veçanti, momentet e planifikimit të përbashkët të punës janë të garantuara midis ekipeve mësimore të seksioneve të moshës homogjene.

Ambientimi

Ambientimi është thelbësor për frekuentimin pozitiv të fëmijës në shkollë; për këtë arsye ekipet shkollore përcaktojnë një projekt specifik, i cili bazohet në parimet e frekuentimit gradual dhe shkëputjes graduale nga figura e prindërve; projekti u paraqitet prindërve gjatë asamblesë së anëtarëve të rinj.

Fëmijët e rinj të regjistruar

Ambientimi në shkollë bëhet në grupe të vogla, duke siguruar vazhdimësinë dhe kohën e qëndrimit gradual dhe mund të shohë praninë (në kohën e dakorduar) të një figure prindërore.

Ambientimi i fëmijës (dreka dhe qëndrimi deri në 14.25) bëhet gjatë tre ditëve.

Kohëzgjatja e pasdites bëhet e mundur duke filluar nga fundi i ambientimit të të gjithë seksionit, i cili zakonisht përfundon brenda tetë ditë pune.

Si pjesë e këtyre udhëzimeve të përgjithshme, mund të parashikohen kohë dhe metoda të ndryshme të ambientimit, të dakorduara midis shkollës dhe familjes.

Në rast të regjistrimeve ose të transferimeve të reja në seksionet 4 dhe 5 vjeç, mësuesit marrin akorde me familjet për ambientimin.

Gjatë fazës së ambientimit të fëmijëve të rinj të regjistruar ose transferuar nga shërbime të tjera, parashikohen takime mes mësuesve dhe prindërve për shkëmbimin e informacionit mbi historinë e fëmijës dhe mbi organizimin e shërbimit.

Fëmijët që frekuntorin edhe vitet e mëparshme

Për fëmijët që frekuntorin edhe vitet e mëparshme, është parashikuar që në dy ditët e para qëndrimi në kopësht është deri në orën 14.25, ndërsa qëndresa në shërbimin e pasdites deri në orën 18.30, është e mundur nga dita e tretë.

Organizimi i stafit

Për funksionimin e kopshteve, sigurohet prania e njësive të personelit mësues, të parashikuara nga Marrëveshja Kolektive Kombëtare e Punës e Autoriteteve Lokale, dhe bashkëpunëtorëve shkollorë. Stafi zgjidhet nga zyrat kompetente të Bashkisë përmes momenteve të dialogut me Kordinimin Pedagogjik në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur për t'ju përgjigjur nevojave arsimore dhe didaktike të shkollës.

Modeli organizativ parashikon caktimin e dy mësuesve për seksionin e fëmijëve që kanë tre vjeç; për seksionet e fëmijëve të moshës katër dhe pesë vjeç zgjidhet një ekip prej tre mësuesish, njëra prej të cilave është mësuesja kujdestare e seksionit dhe një tjetër është mësuesja që shkruan projektet e cila punon në të dyja seksionet. Për shkollat me gjashtë seksione, mësuesja projektuese punon në dy seksionet paralele të moshës homogjene.

Në prani të fëmijëve me aftësi të kufizuara, stafi është i integruar me figura të veçanta profesionale për mbështetje edukative dhe didaktike të programit inkluziv të shkollës.

Zëvendësimet garantojnë në rast të mungesës së personelit, duke marrë parasysh nevojat e shërbimit dhe në përputhje me dispozitat e Kontratës kolektive kombëtare të punës dhe marrëveshjeve të firmuara.

Ekzistojnë gjithashtu figura profesionale specifike për Atelie (*shih paragrafin 8*). Në përputhje me legjislacionin aktual, për ata që e zgjedhin, parashikohet figura e mësuesit të fesë katolike.

Menaxhimi i shërbimeve mbështetëse arsimore dhe didaktike, gjatë kohëzgjatjes pasditore dhe verore, u besohet palëve të treta, në një logjikë të integritetit dhe krahasimit të vazhdueshëm që synon të garantojë vazhdimësinë dhe koherencën e shërbimit në tërësi.

Një ditë e zakonshme

Një ditë tipike në kopshtin e fëmijëve zhvillohet përafërsisht si më poshtë:

7.30 - 8.45: hyrja e fëmijëve

9.00 - 9.15: zamër me bazë frutash

9.15 - 11.30: aktivitete lojërash, propozime didaktike

11.30 - 12.00: përgatitja e vaktit

12.00 - 12.30: dreka

12.30 - 13.00: dalja e parë

13.30 - 14.25: dalja e dytë

14.00 - 15.45: pushim / aktivitete loje për fëmijët që nuk flenë

15.45 - 16.15: zgjim dhe zamër

16.15 - 18.30: dalja e treta dhe aktivitete e lojëra

Organizimi i orarit mund të përshtatet në lidhje me karakteristikat specifike të disa shkollave.

Ushqimi

Shërbimi i mensës në shkollat komunale zakonisht garantohet nga qendra e gatimit të Bashkisë Forli e drejtuar nga një personel i kualifikuar i cili përgatit ushqimet çdo ditë sipas udhëzimeve të dhëna nga Instituti Kombëtar i të Ushqyerit. Për përgatitjen e vaktit, përdoren produkte pa organizma të modifikuar gjenetikut, duke i dhënë përparësi atyre që janë të certifikuar dhe me cilësi të lartë. Pasi të përgatitet, vakti pakëtohet dhe përgatitet për shpërndarje në enë të veçanta termike. Shpërndarja garantohet nga personel i kualifikuar. Kuzhina garanton zhvillimin e dietave specifike për nevojat të veçanta klinike të përdoruesve dhe dietat e kërkuara nga familjet për arsye etiko-fetare ose kulturore. Objektivi kryesor i shërbimit është drejtimi i fëmijës drejt një ushqimi të duhur, të larmishëm, jo të tepruar dhe të ekuilibruar, duke u përpjekur të kapërcejë vështirësitë që mund të dalin nga zakonet e ngrënies tashmë të gabuara, duke përfshirë edhe familjen në dialogun mbi "ushqimin".

Projekti ushqyes në kopshtin e fëmijëve përfshin:

- mëngjes (për fëmijët që hyjnë para orës 8.00);
- një moment ngrënie të bazuar në fruta të freskëta të stinës, në pjesën e parë të mëngjesit;
- dreka e përbërë nga një pjatë e parë dhe e dytë ose, përndryshe, një pjatë e vetme e përbërë nga karbohidrate dhe proteina shtazore ose bimë, një kontorno me perime të gatuar dhe / ose të papërpunuara sezonale, bukë dhe fruta të freskëta sezonale;
- zamër

8. L'ATELIER "Come Ti di Luna"

8. ATELIER "Come Ti di Luna"

Atelieja "Come Ti di Luna" është një shërbim i Bashkisë së Forli që karakterizon dhe kualifikon ofertën shkollare të kopshteve komunalë, duke propozuar kurse didaktike në të cilat arti kuptohet si një gjuhë themelore edukative.

Atelieristet, mësuese me përvojë dhe formim specifik mbi temat e mësimin të artit dhe të trashëgimisë muzeale, u ofrojnë fëmijëve shtigje të njohjes së botës përmes artit. Në projektet didaktike të propozuara, arti është përdorur si një mundësi që djali dhe vajza të ndiejnë, vëzhgojnë, kuptojnë, njohin dhe përfaqësojnë realitetin, si edhe një mjet komunikimi dhe shprehjeje. Falë përvojave të ofruara, të cilat bazohen në veprimin dhe ndjenjën, fëmijëve u ofrohen mundësi për të zhvilluar një këndvështrim kurioz, pyetës dhe krijues mbi botën.

Në çdo kopsht komunal, ekziston një hapësirë e veçantë kushtuar mësimin të aktiviteteve artistike të kryera nga figura e atelieristes.

Zhvillimi i projekteve është i garantuar në kopshte dhe, në mënyrë eksperimentale, mund të realizohet edhe në çerdhe.

Atelie, përveç kryerjes së projekteve drejtpërdrejt në shërbimet e shkollave bashkiake, bashkëpunon me Shërbimin e Kulturës dhe Turizmit për realizimin e aktiviteteve mësimore muzeale në të gjitha kopshtet e zonës, me lloje të ndryshme menaxhimi.

Në përgjithësi, moshat për të realizuar propozimet e Ateliesë mund të shkojnë nga çerdhja në kopsht; në ndonjë rast mund të përshtatet edhe për dy vitet e para të shkollës fillore.

Përveç zbatimit të projekteve të mësimin të artit në kopshtet komunale dhe bashkëpunimit me muzetë për didaktikën muzeale, Atelie ofron shërbimet e mëposhtme për çerdhet dhe kopshtet.

SPORTEL KONSULTUES

Sporteli i konsulencës Atelie i lejon edukatorët dhe mësuesit të kenë një mbështetje të specializuar në lidhje me mundësitë artistike që do të përfshihen në realizimin e projektit pranë seksionit të tyre dhe pastaj ta zhvillojnë në mënyrë të pavarur.

Sporteli përqëndrohet në disa kite (propozime kurrikulare në valixhe) dhe propozime didaktike, të krijuara dhe të testuara nga Atelie në shkollat komunale. Falë sportelit, mësuesit mund të mësojnë dhe ri-proponojnë këto eksperiencë, madje edhe duke i përshtatur ato, nën udhëzimet e atelieristeve.

KITET DIDAKTIKE

Këto janë propozime pune me temë, rezultat i ripërpunimit të disa projekteve të rëndësishme të eksperimentuara në të kaluarën nga Atelie në kopshtet dhe çerdhet komunale.

Kitet përbëhen nga një grup skedash shpjeguese të aktiviteteve që do të propozohen duke përdorur lloje të ndryshme materiale, që do të përdoren për realizimin e vetë aktiviteteve, të futura në valixhe të veçanta (ose përmbajtës të tjerë). Ato kanë për qëllim të lehtësojnë punën e mësuesve dhe edukatorët për realizimin e projekteve.

Konsultimi dhe huazimi i kiteve janë të mundshme.

BIBLIOTEKA

Biblioteka përbëhet nga një shumëllojshmëri tekstesh që i dedikohen artit: katalogë, dokumentacion mbi trashëgiminë artistike të qytetit të Forlì-s, monografi artistësh, libra dhe revista, tekste dhe seri librash didaktikë arti, vepra letrare për fëmijë me tema mbi artin dhe mbi edukimit ndaj së bukurës. Biblioteka ofron shërbime konsultimi dhe huazimi për të gjithë sistemin e kopshteve të territorit, për studentët dhe operatorët e sektorit.

Së fundi, Atelie kryen aktivitete të përqendruara në mësimdhënien e artit dhe / ose në njohjen e trashëgimisë artistike dhe kulturore të qytetit përkushtuar prindërve dhe fëmijëve, në kuadrin e bashkëpunimit me Qendrën Familjare të Romagna Forlivese dhe / ose me nisma të tjera të karakterit institucional.

9. LA BIBLIOTECA PEDAGOGICA "DUILIO SANTARINI"

9. BIBLIOTEKA PEDAGOGJIKE "DUILIO SANTARINI"

Një shërbim për kualifikimin e shërbimeve arsimore 0/6 vjeç është Biblioteka Pedagogjike "Duilio Santarini", e menaxhuar drejtpërdrejt nga Koordinimi Pedagogjik i Bashkisë së Forlì-s. Ajo i drejtohet kryesisht profesionistëve që merren me shkollën dhe arsimin, si mësuesit, edukatorët, bashkëpunëtorët arsimorë, pedagogët, psikologët, punonjësit socialë dhe shëndetësorë, studentë, por gjithashtu paraqet si një burim për familjet dhe qytetarët.

Ajo promovon përhapjen e një kulture të fëmijërisë në të gjithë territorin dhe mbështet trajnimin e përhershëm e të vazhdueshëm të operatorëve të shërbimeve arsimore, me synimin për të ndërtuar dhe mbajtur një sistem trajnimi të integruar kompetent dhe cilësor.

Biblioteka i është titulluar mjeshtrit Duilio Santarini, një figurë themelore që ndihmoi në lindjen dhe zhvillimin e shërbimeve arsimore forliveze në vitet '70.

Ajo është e specializuar në çështjet pedagogjike, veçanërisht në lidhje me grupmoshën 0/6 vjeç. Ofron një shërbim të rregullt të hapjes për publikun¹ për konsultim dhe huadhënie, duke përfshirë konsulencën ndër - bibliotekare për kërkimet tematike dhe për hartimin dhe prodhimin e dokumentacionit edukativ, përfshirë multimedial; organizon ekspozita, takime trajnimi dhe seminare mbi çështjet e reja në fushën arsimore. Biblioteka është pjesë e Rrjetit të Bibliotekave të Romanjës dhe San Marino.

Në bibliotekë është në dispozicion një përzgjedhje specifike e librave të ilustruar, nga e cila mësuesi

¹ Për kontaktet biblioteca.santarini@comune.forli.fc.it

dhe prindi mund të marrin frymëzim për të trajtuar çështje veçanërisht të vështira dhe delikate për fëmijët.

10. IGIENE, SALUTE E SICUREZZA

10. HIGJENA, SHËNDETI DHE SIGURIA

HIGJENA MJEDISORE

Higjiena korrekte dhe e sigurt e mjedisit rrjedh nga njohuritë dhe veprimet e shumta.

Metodat e përdorimit të produkteve dhe pajisjeve të pastrimit, procedurat dhe teknikat e pastrimit të përdorur nga stafi, i gjeni në planin e pastrimit që secili kompleks ka dhe përputhet me dispozitat e Ndërmarrjes USL².

NORMAT E SHËNDETËSORE

Mbrojtja e shëndetit të fëmijëve që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet sigurohet nga Pediatria e komunitetit, sipas dispozitave të "*Kritereve të Shëndetit dhe Higjienës për frekuentimin në komunitetet arsimore dhe shkollore*"³ të miratuara nga Ndërmarrja kompetente USL. Është një pjesë integrale e dokumentit të lartpërmendur: udhëzimet për heqjen e gjirit në çerdhe dhe shtëpi dhe grupi i procedurave që lidhen me përdorimin e dietave speciale, përdorimit të qumështit të gjirit në shërbimet edukative, administrimit të ilaçeve në çerdhe dhe në shkolla dhe përdorimi i pelenave që lahen, në shërbimet edukative për fëmijët.

SIGURIA

Në çerdhet dhe kopshtet, garantohet një hapësirë e përshtatshme (e brendshme dhe e jashtme) për fëmijët në përputhje me rregulloret aktuale, rajonale dhe shtetërore.

Shërbimet teknike komunale, secili për kompetencat e veta përkatëse, garantojnë mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ndërtesave që strehojnë çerdhet dhe kopshtet, kujdesin dhe sigurinë e brendshme dhe hapësirat e gjelbërta në natyrë, përfshirë orenditë dhe lojërat.

Vëmendje e veçantë i kushtohet pajtueshmërisë me legjislacionin për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës (Dekreti Legjislativ 81/08): në çdo çerdhe / shkollë stafi mësimdhënës dhe ndihmës trajnohen me njohuri mbi Zjarrfikjet dhe Ndihmën e Parë dhe në personelin e trajnuar, identifikohet një figurë për secilin kompleks, që merr përsipër të kordinojë të gjitha veprimet e parashikuara nga Plani i Emergjencës. Prova të evakuimit kryhen disa herë gjatë vitit shkollor, në përputhje me ligjin; ashtu siç simulohen disa herë llojet e tjera të emergjencave, në përputhje me sugjerimet e Mbrojtjes Civile.

11. OCCASIONI E ORGANISMI DELLA PARTECIPAZIONE

11. MUNDËSITË DHE ORGANIZMAT E PJESËMARRJES

Mundësitë dhe organizmat e pjesëmarrjes

Pjesëmarrja aktive e familjeve në shërbimet e ofruara përfaqëson një të drejtë dhe një mundësi të çmuar, falë së cilës zhvillohen proceset e përfshirjes dhe bashkëpunimit, strukturohen format e takimit dhe komunikimit dhe realizohet ushtrimi i përgjegjësisë.

Promovimi i pjesëmarrjes së prindërve mishërohet në njohjen e projektit pedagogjik, në shkëmbimin e informacionit, në organizimin e takimeve formale dhe joformale. Ka për qëllim ndërtimin e një aleance edukative dhe planifikimin koherent dhe të përbashkët, për të siguruar vazhdimësinë shkollore të përvojës së fëmijëve.

² Aneksi 7 i "*Kritereve të shëndetit dhe higjienës për pjesëmarrjen në komunitetet arsimore dhe shkollore*"

³ Shkarkohet nga faqja e internetit www.comune.forli.fc.it, seksioni i fëmijërisë

Projektimi dhe zbatimi i mundësive të ndryshme për takimin e familjeve është e rëndësishme për të promovuar shkallë të ndryshme të pjesëmarrjes, në mënyrë që gradualisht të ndërtohet një kontekst arsimor i integruar bashkëpunues midis shërbimeve dhe familjeve, në të cilin projekti arsimor i çerdhes dhe kopshtit ndërthuret me projektin edukativ të familjes.

Tashmë në ditën e hapur mund të fillohet ndërtimi i pjesëmarrjes, në këtë moment fillojnë dialogët e parë midis personelit të shërbimit dhe familjeve, referimet pedagogjike dhe organizative bëhen të qarta, vizitohen hapësirat ku do të dërgohen fëmijët.

Një moment themelor i fillimit të përvojës përsa i përket shërbimeve 0-6 përfaqësohet nga ambientimi, është fillimi i rrugës së dijes dhe bashkëndarjes që kërkon gradualitet dhe relaks. Cilësia e ambientimit është vendimtare për një frekuentim pozitiv të fëmijës dhe për ndërtimin e një aleance edukative mes operatorëve dhe familjeve, për këtë arsye ekipet arsimore ndërtojnë një projekt specifik të bashkëndarë me prindërit, me rastin e asamblesë së anëtarëve të rinj.

Gjatë fazës së ambientimit, janë planifikuar takime mes edukatorëve / mësuesve dhe prindërve për një shkëmbim informacionesh mbi historinë e fëmijës dhe mbi organizimin e jetës në çerdhe dhe kopshte. Gjatë vitit edukativo-shkollor, janë planifikuar momente të tjera të dialogut, që synojnë bashkëndarjen e aspekteve që lidhen me rritjes e fëmijëve. Takimet mund të kërkohen, si nga edukatorët / mësuesit, po ashtu edhe nga prindërit, sipas nevojave të tyre të veçanta.

Mundësitë themelore për pjesëmarrje përfaqësohen nga asambletë. Në fillim të çdo viti edukativo-shkollor, asambleja e përgjithshme organizohet për tu prezantuar familjeve operatorët, organizimin e shërbimit dhe ofertën specifike të formimit. Asambletë e seksioneve janë planifikuar gjatë vitit për të ndarë me familjet linjat e projektit edukativ dhe didaktik dhe për të promovuar dialogun midis prindërve dhe edukatorëve / mësuesve.

Ushtrimi i pjesëmarrjes së prindërve në jetën e këtyre shërbimeve garantohet nga krijimi i disa organeve përfaqësuese: Komiteti i Menaxhimit dhe Këshilli. Në asamblenë e përgjithshme në fillim të vitit, zgjidhen prindërit që janë anëtarë të Komitetit Menaxhues dhe përfaqësuesit e prindërve në Komisionet e Këshillit⁴.

Bashkia njeh forma të tjera të pjesëmarrjes, të tilla si Shoqatat e Prindërve, me qëllim promovimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen e jetës në çerdhe e kopshte, duke e pasuruar dhe duke zhvilluar një lidhje virtuale edhe me territorin.

REGULLORE KOMUNALE E SHËRBIMEVE Edukative DHE SHKOLLORE 0-6 VJEÇ
Shtojca B) e Rezolutës së Këshillit Bashkiak nr. 31 datë 15.05.2018

PJESA E PARË - E SHËRBIMEVE KOMUNALE PËR FËMIJË

TITULLI III - Pjesëmarrja e familjeve

Neni 11. Organizmat e pjesëmarrjes

Pjesëmarrja e prindërve garantohet përmes organeve të mëposhtme:

- Asambleja e Përgjithshme
- Asambleja e seksionit
- Komiteti i menaxhimit
- Konsulta

Neni 12 Asambleja e Përgjithshme

Përbëhet nga të gjithë prindërit dhe operatorët e çerdheve ose shkollave. Kordinatori pedagogjik përgjegjës mund të marrë pjesë në të.

Thirrjet, në mënyrë të zakonshme, në fillim të çdo viti edukativ / shkollor nga ekipi arsimor për të paraqitur operatorët, organizimin e shërbimit dhe ofertën specifike të formimit.

Në Asamblenë e Përgjithshme të fillim të vitit, zgjidhen prindërit që janë anëtarë të Komitetit Menaxhues (Presidenti,

⁴ Për detaje mbi organizatat mbajtëse, shihni kutinë specifike.

Z/Presidenti, Arkëtari, Z/Arkëtari dhe të paktën dy përfaqësues për secilin seksion) dhe përfaqësuesit e prindërve në Komisionet e Konsultës (ekonomike, mensa dhe pedagogjike).

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret, në rrugë të jashtëzakonshme, me iniciativën e ekipit arsimor ose të Komitetit Menaxhues.

Jashtë Asamblesë së Përgjithshme, grupeve të prindërve u jepet mundësia, me kërkesë të motivuar, të takohen brenda çerdhes ose shkollës; autorizimi lëshohet nga drejtuesi kompetent komunal, pas vlerësimit të qëllimit të takimit.

Neni 13 Asambleja e Seksionit

Konsiston në një takim midis stafit të seksionit dhe prindërve të fëmijëve.

Zakonisht thirret nga ekipi i edukatorëve / mësuesve, jo më pak se dy herë në vit, për të paraqitur, diskutuar dhe verifikuar planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve edukative dhe mësimore.

Ekipi i edukatorëve / mësuesve do të kujdeset që t'u sigurojë prindërve informacion dhe dokumentacion të përshtatshëm për të lehtësuar kuptimin e zgjedhjeve arsimore dhe pjesëmarrjen aktive, si përmes pyetjeve ashtu edhe përmes kontributeve aktive të vetë prindërve.

Asambleja e seksionit është konfiguruar si një moment për paraqitjen e projektit edukativ dhe për diskutimin midis prindërve dhe edukatorëve / mësuesve.

Neni 14 Komiteti Menaxhues

Ai përbëhet nga prindër të zgjedhur në Asamblenë e Përgjithshme në fillim të vitit (Presidenti, Z/Presidenti, Arkëtari, Z/Arkëtari, përfaqësuesit e seksioneve, përfaqësuesit e prindërve në Komisionet e Konsultës), nga personeli / mësuesi dhe bashkëpunëtorët arsimor dhe nga kordinatori pedagogjik i referimit.

Të gjithë anëtarët e lartpërmendur kanë të drejtë vote.

Komiteti Menaxhues është organi që i jep qëndrueshmëri operative pjesëmarrjes së familjeve. Për këtë arsye, të gjithë prindërit mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote.

Komiteti Menaxhues qëndron në detyrë për një vit dhe takohet, me thirrje të zakonshme, të paktën tre herë. Mbledhjet thirren nga Presidenti, ose me kërkesën të paktën, të një të tretës së anëtarëve.

Vendimet e marra nga Komiteti i besohen, për ekzekutim, autonomisë së plotë të anëtarëve të tij që marrin përgjegjësinë për të dhe i përgjigjen Komitetit si organ kolegjial.

Komiteti:

- shqyrton çdo problem të funksionimit, përcjell kërkesat, formulon komentet mbi strukturën dhe funksionimin e çerdhes ose kopshtit;
- diskuton dhe shpreh opinione mbi projektet e eksperimentimit që kanë pasoja në organizimin e përditshëm të çerdhes ose shkollës;
- mund të kërkojë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për çështje që lidhen me të gjithë shërbimin. Komiteti, i koordinuar me Shoqatën e Prindërve, aty ku ekziston:
- ka një rol promovimi kulturor;
- propozon dhe organizon, veçanërisht, nisma që synojnë promovimin dhe pjesëmarrjen e prindërve në jetën e çerdhes ose kopshtit dhe, në përgjithësi, në studimin e problemeve specifike arsimore;
- menaxhon burimet ekonomike të vëna në dispozicion nga Administrata Komunale duke marrë parasysh projektin edukativ të çerdhes / shkollës dhe të zgjedhjeve pedagogjike të grupit të punës edukative;
- propozon dhe organizon, në veçanti, nisma që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së prindërve në jetën e çerdhes ose kopshtit (festa, vizita didaktike, projekte bibliotekare, etj.) dhe, në përgjithësi, studimin e temave të veçanta arsimore.

Presidenti, në marrëveshje me ekipin, formulon O.d.G. të Komitetit dhe verifikon ekzekutimin e vendimeve të marra. Presidenti siguron qarkullimin e informacionit midis operatorëve, prindërve dhe Administratës duke adoptuar metoda që sigurojnë përhapjen maksimale të informacionit dhe promovojnë përfshirjen e familjeve.

Neni 15 Konsulta

Konsulta përbëhet nga Kryetarët e Komiteteve të shkollave dhe çerdheve komunale nën menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe me koncesion.

Në të marrin pjesë përfaqësuesit e operatorëve të shërbimit (një për shërbim), kordinatorët pedagogjikë, asesori, drejtori dhe shefi i zyrës komunale të referencës ose delegatët e tyre.

Të gjithë anëtarët e Konsultës, të identifikuar më parë, kanë të drejtë vote. Në lidhje me temat specifike që do të diskutohen, subjekte të tjera mund të ftohen të marrin pjesë, pa të drejtë vote.

Konsulta zgjedh, nga ana e prindërve, një President dhe një Z/President.

Presidenti dhe Zëvendës Presidenti qëndrojnë në detyrë për një vit dhe mund të rizgjidhen edhe për dy vite të tjera. Presidenti (ose, në mungesë të tij, Z/Presidenti) thërret, në marrëveshje me përfaqësuesit e Bashkisë, Konsultën

sipas një kalendari të paracaktuar në fillim të çdo viti edukativ / shkollor.

Temat që do t'i paraqiten Konsultës përcaktohen nga Presidenti duke marrë parasysh propozimet e bëra nga Presidentët e Komiteteve dhe / ose nga përfaqësuesit e Bashkisë.

Konsulta mund të thirret, në mënyrë të jashtëzakonshme, me kërkesë të së paku tre komiteteve menaxhuese ose nga Drejtuesi komunal.

Si rregull, Konsulta organizon punën e saj nëpërmjet komisioneve të mëposhtëm, të cilët përfshijnë, përveç anëtarëve të vetë Konsultës, përfaqësues të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e secilit shërbim:

- Komisioni Ekonomik;
- Komisioni i mensës;
- Komisioni pedagogjik.

Konsulta gjithashtu mund të përdorë Komisione të tjera, të ngritura, herë pas here, për të përballuar problemet specifike që mund të shfaqen dhe që kërkojnë pjesëmarrjen e prindërve.

Këshilli shpreh opinione dhe bën propozime për:

- organizimin e shërbimeve;
- kriteret për qasjen në shërbime;
- iniciativat kulturore;
- iniciativa për rakordimin e çerdheve / kopshteve dhe kopshteve / shkollave fillore;
- aktivitete eksperimentimi;
- projekte dhe aktivitete plotësuese.

Mendimi i Këshillit kërkohet detyrimisht në lidhje me programet e riorganizimit të shërbimeve.

12. ACCESSO AI SERVIZI E CONTRIBUZIONE

12. PJESEMARRJA NË SHËRBIME DHE KONTRIBUTI

HYRJA NË ÇERDHE

Për tu shkruar në çerdhe duhet aplikuar për regjistrim. Metodat dhe koha për paraqitjen e aplikacioneve (afërsisht në muajt mars-prill) përcaktohen çdo vit dhe publikohen në faqen e internetit institucional të Komunës së Forlì www.comune.forli.fc.it në seksionin e Çerdheve.

Përzgjedhja e aplikacioneve bëhet në bazë të kriterëve të miratuara nga administrata komunale dhe bëhen publike.

Pranimi i një vendi në çerdhe çon në pagesën e një tarife të pakthyeshme, shuma e së cilës përcaktohet çdo vit në të njëjtën kohë me përcaktimin e tarifave.

Pjesëmarrësit kontribuojnë me mbulimin e pjesshëm të kostove të paraqitura nga Komuna, me një tarifë mujore e cila parashikon një tarifë të diferencuar, bazuar në llojin e shërbimit të përdorur:

- a) koha e reduktuar (orari e daljes 12.30 / 13.00);
- b) koha normale (orari i daljes 15.30 / 16.00);
- c) koha e zgjatur (orari i daljes pas orës 16.00)

Tarifa mujore përcaktohet në bazë të një gradualiteti të kontributit të pjesëmarrësve sipas parimeve të barazisë dhe solidaritetit, në lidhje me kushtet aktuale socio-ekonomike të familjeve.

Brenda ciklit shkollor të Çerdhes, pas regjistrimit të pare, konfirmimi i vendit për vitet që vijojnë, është automatik.

Tërheqja nga shërbimi mund të bëhet me shkrim, në çdo kohë të vitit, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloret e Tarifave të miratuara me Rezolutën e C.C. n 31 të 15/05/2018 si dhe ndryshimet dhe shtesat pasuese.

Në rast të mungesave të zgjatura dhe të pajustificuara dhe / ose shkeljeve të përsëritura të rregullave të funksionimit të shërbimeve, e drejta për të marrë pjesë humbet.

HYRJA NË KOPSHTË

Për tu shkruar në kopësht duhet aplikuar për regjistrim. Metodat dhe koha për paraqitjen e aplikacioneve (në mënyrë indikative në muajt janar-shkurt) përcaktohen çdo vit nga një Qarkore specifike Ministrore dhe publikohet në faqen internet institucionale të Komunës së Forlì www.comune.forli.fc.it në seksionin e Kopshtit të Fëmijëve.

Përzgjedhja e aplikimeve bëhet në bazë të kriterëve të miratuara nga administrata komunale dhe bëhet publike.

Pranimi i vendit në Shkollë nënkupton bërjen e një pagese mujore, që duhet të paguhet nga frekuentuesit dhe përbëhet nga:

- a) tarifa për mensën shkollore (tarifë fikse e shërbimit + tarifë e ushqimit për numrin e vakteve të konsumuara);
- b) tarifë fikse mujore;
- c) tarifa fikse për shërbimin e pasdites, nëse kërkohet (llogaritet në lidhje me masën e shërbimit: dy pasdite në javë ose më shumë se dy pasdite në javë).

Tarifa mujore e shkollimit identifikohet në bazë të një gradualiteti të kontributit të pjesëmarrësve sipas primeve të barazisë dhe solidaritetit, në lidhje me kushtet aktuale socio-ekonomike të familjeve.

Brenda ciklit shkollor, konfirmimi i vendit ,për vitet pas regjistrimit të pare, është automatik.

Tërheqja nga shërbimi mund të bëhet me shkrim, në çdo kohë të vitit, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloret e Tarifave të miratuara me Rezolutën e C.C. n 31 të 15/05/2018 si dhe të ndryshimeve dhe të pagesave shtuese.

Në rast të mungesave të zgjatura dhe të pajustificuara dhe / ose shkelje të përsëritura të rregullave të funksionimit të shërbimeve, e drejta për të marrë pjesë humbet.

KONTRIBUTI

Ndihmat tarifore jepen duke marrë parasysh kriteret ekonomike dhe sociale të përcaktuara në bazë të Deklaratës ISEE sipas DPCM 159/2013 dhe ndryshimet e integritimeve.

Tarifa e personalizuar e llogaritur në bazë të vlerës së ISEE (kufiri maksimal i së cilës përcaktohet nga viti në vit nga Këshilli Rajonal) mbetet i vlefshëm për të gjithë vitin shkollor.

Koncesionet tarifore nuk janë të detyrueshme, prandaj për frekuentuesit që nuk japin deklaratën ISEE ose që tejkalojnë kufirin maksimal të përcaktuar ose që nuk autorizojnë zyrën kompetente të konsultojë dokumentat, i vihet tarifa maksimale për llojin e shërbimit të kërkuar.

Zyrat kompetente japin çdo vit një informacionin të gjerë se si të regjistrohen dhe aplikohen tarifat. Për të gjitha informacionet në lidhje me metodat e hyrjes, regjistrimit / heqjes dorë, tarifat dhe rregulloret në fuqi, ju lutemi referojuni faqes së internetit të Komunës së Forlì [www. forli.fc.it](http://www.forli.fc.it) e cila përmban informacione të reja periodikisht.

13. INFORMAZIONI, RIFERIMENTI E CONTATTI

13. INFORMACIONI, REFERENCAT DHE KONTAKTET

- **INFORMACION DHE PRAKTIKA ADMINISTRATIVE TË LIDHURA ME SHËRBIMET EDUKATIVE DHE SHKOLLORE (regjistrimet, pranimet, konfirmimet, tarifat, transferimet, heqjet dorë, tarifat, Rregulloret, etj)**

Sporteli Unik i Shërbimeve Edukative dhe Shkollore Via C. Sforza, 16 (Kati përdhes)

Tel. 0543/712340/712325/712116/712425 - E -mail: info.scuolainfanzia@comune.forli.fc.it

(regjistrimet, pranimet, konfirmimet, transferimet, heqjet dorë, Rregulloret, etj)

Tel. 0543/712115/712388 - E -mail: sistematariffario@comune.forli.fc.it

(tarifat, pagesat, konfirmimet, borxhet bankare, çertifikatat e pagesave, pagesat online, etj)

- **INFORMACION LIDHUR ME ORGANIZIMIN E ÇERDHEVE / SHKOLLAVE** (caktimi i stafit, menaxhimi i graduatorieve për rolet dhe zëvendësuesit, marrëdhëniet me kooperativat për shërbimin e zgjatjes së orarit të pasdites dhe verës në çerdhet dhe kopshtet dhe shërbimet ndihmëse në kopshtet, marrëdhëniet me shërbimet komunale mbështetëse - ndërtimi publik , parandalimi dhe mbrojtja, logjistika, mjedisi, gjelbërimi publik, etj.)

Njësia e Fëmijërisë Via C. Sforza, 16 (kati i ndërmjetëm)

Tel. 0543/712380/712381/712385/712803 - E -mail: ufficiosupplenze@comune.forli.fc.it